



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE INTEGRIMIT
EVROPIAN

Nr. 1487 Prot

Himarë, më 20.03 2024

PROJEKTVENDIM

Nr. 10 Datë 20.03 2024

“PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË BASHKISË PËR VITIN 2024”

Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 9936 datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” ligjin Nr 10296 datë 08.07.2010. “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave “Mbi procedurat standarte të miratimit të buxhetit”, të ndryshuar, mbi njoftimin për transfertën e pakushtëzuar e përgjithëshme dhe sektoriale, për vitin 2024,”

VENDOS:

1. Të miratohet projektbuxheti faktik i vitit 2024.
2. Të miratohet tabela e të ardhurave faktike për vitin 2024 (Tabela 1.0)
3. Të miratohet tabela e detyrimeve të prapambetura faktike 2024 (Tabela 2.0)
4. Të miratohet tabela e shpenzimeve operative dhe investimeve shtesë (Tabela 3.0)
5. Drejtoria e financës, planifikimit të buxhetit dhe integritimit evropian, sektori i financës, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Keshilli Bashkiak sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave .
6. Ndryshimet të pasqyrohen në PBA 2025- 2027.

Drejtor i DFPBIE

Laert Mezani

KRYETARI I BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

**DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE INTEGRIMIT
EVROPIAN**

Nr. 1487/Prot
2

Himarë, më 2003.2024

PROJEKTBUXHETI FAKTIK I VITIT USHTRIMOR 2024

Tabela e lëndës

KAPITULLI I: INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BUXHETIN FAKTIK TË BASHKISË PËR VITIN 2024 DHE NDRYSHIMET.....	1
KAPITULLI II. TE ARDHURAT E BASHKISË HIMARË PËR BUXHETI FAKTIK 2024.	1
KAPITULLI III. SHPENZIMET E BASHKISË HIMARË PËR VITIN 2024 SIPAS BUXHETIT FAKTIK.	3
SHPENZIMET PER PAGAT DHE SIGURIMET SHOQËRORE.....	3
DETYRIMET E PRAPAMBETURA NË BUXHETIN FAKTIK.....	4
SHPENZIMET OPERATIVE INVESTIMET E BUXHETIT FAKTIK 2024.....	5

KAPITULLI I: INFORMACION I PËR GJITHSHËM MBI BUXHETIN FAKTIK TË BASHKISË PËR VITIN 2024 DHE NDRYSHIMET

Bazuar ne ligjin nr. 139/2015 neni 16 pika 1 “Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes” si dhe ligjit Nr. 68, date 27.04.2017 “Per financat e vetëqeverisjen vendore”, neni 5, pika ç “Programet buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore vendore konsultohen me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore.”, Bashkia Himarë ka kryer nje seri konsultimesh me komunitetin dhe grupet e interesit sipas nje kalendari te percaktuar.

Gjithashtu janë kryer rakordimet e të ardhurave dhe shpenzimeve faktike deri më 31.12.2023, duke nxjerrë edhe një pasqyrë më të qartë të gjendjes financiare dhe planifikimin për vitin 2024.

KAPITULLI II. TE ARDHURAT E BASHKISË HIMARË PËR BUXHETI FAKTIK 2024.

Gjatë përgatitjes së buxhetit të vitit 2024, janë marrë konsideratë të gjithë faktorët makroekonomik, situata e përgjithëshme vendore, rajonale dhe shtetërore duke pasur si fokus parashikimin sa më realist të të ardhurave për vitin në vijim. . Ndër faktorët e përdorur mund të përmendim rritjen reale ekonomike, normën e inflacionit si dhe parashikime nga institucione qëndrore is Banka e Shqipërisë, INSTAT por edhe burime informacioni nga agjentë të tjerë.

Nga të dhënat të cilat nuk ishte parashikuar në buxhetin e mëparshëm, kanë qene norma e inflacionit, e cila nga mesatarja e përllogaritur 2.5-3 %, ka kapërcyer vlerën 5% sipas INSTAT. Po ashtu në këtë këndvështrim është bërë edhe parashikimi i rritjes tej normës për energjinë elektrike, por edhe energjisë në përgjithësi.

Të ardhurat e Bashkisë Himarë, pas rakordimit me Degën e Thesarit Vlorë, mbi gjendjen aktuale të llogarive ekonomike dhe te ardhurave te trashëguara nga viti 2023, rezulton se totali i të atdhurave të trashëguara është 1,052,720,008 lekë nga 906,687,123 lekë të parashikuara nga administrata që do të trashëgoheshin për vitin 2024. Kjo diferencë vjen për shkak se projektbuxheti vjetor i paraqitet Këshillit Bashkiak me të dhënat e rakorduara deri në Nëntor të vitit ushtrimor, duke prezumuar zbatimet buxhetore dhe parashikimet e të ardhurave për muajin Dhjetor. Diferencat e përllogaritura të paraqitura pranë jush përbëjnë shpenzimet e muajit

Dhjetor si pagat e administratës pagesat ndaj furnitorëve si oshee dhe të tjerë, po ashtu edhe të ardhura të parashikuara për emergjencat civile dhe parandalimin e fatkeqësive natyrore shkojnë nga 2,500,000 lekë të parashikuar në 15,652,470 lekë . Si pasojë të gjithë të ardhurat e bashkisë për vitin 2024 shkojnë në vlerën **1,975,471,478 lekë** nga **1,816,286,123 lekë**. Kjo diferencë përkon me pagesat e kryera për kontrata në vijim të Bashkisë Himarë.

Nr	Emertimi i te Ardhurave Tatimore	MARS 2024
I.	Te ardhura nga taksa	389,300,000
1	Tatim i thjeshtuar mbi Biznesin	5,000,000
2	Taksa Vjetore e Mjeteve te Perdorura	3,500,000
3	Taksa mbi kalimin e te drejtes se Pronesise	10,000,000
4	Taksa mbi Renten Minerare	1,500,000
5	Tatimi i te ardhurave personale	3,800,000
6	Taksa e Nderteses	35,000,000
7	Taksa e Truallit	4,500,000
8	Taksa e Tokes Bujqesore	4,500,000
9	Taksa e Ndikimit ne Infrastrukture	300,000,000
10	Taksa e Fjetjes ne Hotel	20,000,000
11	Taksa te Perkohshme	
12	Takse Reklame	1,500,000
II.	Te ardhura nga tarifat	221,500,000
1	Tarife Pastrimi	90,000,000
2	Tarife Gjelberimi	10,000,000
3	Tarife Ndricimi	10,000,000
4	Tarife Per Zenien e Hapsires Publike	90,000,000
5	Tarifa per Leje Ndertimi	7,000,000
6	Tarife per Sherbime Komunale	5,000,000
7	Tarifa per Sherbime Administrative	2,000,000
8	Tarife KUZ	1,000,000
9	Tarife Parkimi	3,000,000
10	Tarife Leje Licenca	500,000
11	Kamatevonesa	1,000,000
12	Gjoba	2,000,000
III.	Te ardhura nga shitja e prones dhe dhenia me qera	10,000,000
1	Shitje te Pasurive te Paluajtshme	
2	Qira Ndertesa	1,000,000
3	Qira Troje	4,000,000
4	Qira Kullota	5,000,000
IV	Te ardhurat gjithsej (I+II+III)	620,800,000
1	Te ardhura te trasheguara nga 2023	1,052,720,008.00

2	Te ardhura nga debitor te prapambetur	25,000,000.00
3	Te ardhura nga transferta e pakushtezuar e pergjithshme	159,741,000.00
4	Te ardhura nga granti I pakushtezuar sektorial	63,313,000.00
5	Transferta Specifike	38,245,000.00
6	Granti specifik Mbrojtja Civile	15,652,470
	Totali	1,975,471,478.00

(Tabela 1.0)

Tabela e mëposhtëme 1.0 paraget të ardhurat për buxhetin faktik 2024

Në prezantimin e projektvendimit të buxhetit faktik për vitin 2024, kemi parashikur ndryshime në parashikimin e të ardhurave të Bashkisë Himarë, si me të ardhurat e veta apo nga grantet e qeverisjes qëndrore.

KAPITULLI III. SHPENZIMET E BASHKISË HIMARË PËR VITIN 2024 SIPAS BUXHETIT FAKTIK.

Bazuar në parashikimin e të ardhurave, bashkia ka bërë shpërndarjen e tyre në bazë të nevojave dhe kërkesave ligjore përkatëse. Totali i shpenzimeve të parashikuara do të jetë i barabartë me totalin e të ardhurave të parashikuara për vitin 2024.

Nga rakordimet me degën e thesarit Vlorë, në lidhje me detyrimet e prapambetura, u bënë sistemimet përkatëse duke evidentuar të gjitha detyrimet e prapambetura. Shpenzimet e kryera deri ne 31,12,2023 janë pasqyruar në këto ndryshime.

Duke llogaritur të ardhurat e shtuara përkundrejt shpenzimeve, nga rakordimi me degën e thesarit Vlorë, është bërë gjithashtu balancimi I totalit të të ardhurave të parashikuara me atë të shpenzimeve të parashikuara.

SHPENZIMET PER PAGAT DHE SIGURIMET SHOQËRORE

Nga rakordimet me degën e thesarit rezultojnë diferenca në programin buxhetor “*Administrimi i pyjeve dhe kullotave*” me vlerë prej 600,000 lekë. Kjo diference do të kompesohet me rritjen e vlerës të këtij programi buxhetor për llogaritë ekonomike 600 dhe 601 me 600,000 lekë, pra totali i fondit të pagave nga 198,314,000 lekë bëhet 198,914,000 lekë.

DETYRIMET E PRAPAMBETURA NË BUXHETIN FAKTIK

Detyrimet e prapambetura, si tëtësi e mallrave, shërbimeve dhe investimeve të pagueshme në vitin korrent 2024, përbëjnë një pjesë tjetër të rëndësishme të buxhetit. Me rakordimet e buxhetit faktik 2024 ku në të cilinin përfshihen të gjitha ato pagesa të likujduara për llogari të vitit 2023, ka një diferencë e cila vjen si pasojë e likujdimev të kryera në muajit Dhjetor 2023 deëi më 26.01.2024 (periudha e fundit ku mund të kryhen shpenzime për llogari të vitit paraardhës). Si pasojë detyrimet e prapambetura kanë pësuar ulje të tyre nga vlera 385,518,248 lekë në 208,746,568 lekë, nga të cilat 40,662,698.40 lekë për mallra dhe shërbime dhe 168,083,869.60 pëe investime, pra një zbritje me 176,771,680 lekë në total.

Tabela e mëposhtëme tregon detyrimet e prapambetura në buxhetin faktik 2024:

Kod llog	Emertimi	Mbetur 2024
602	Shërbimi i internetit për administratën e bashkisë	408,000.00
231	RIKONSTRUKSION I RRUGËS PANORAMIKE PILUR	8,613,657.00
231	RIKONSTRUKSION I K.U.Z QEPARO HIMARË	6,028,687.20
602	Blerje materiale kancelarie	1,176,026.35
602	Blerje karburant për mjetet e bashkisë	2,936,339.05
231	RIKONSTRUKSION I RRUGËS NË LAGJEN GREHOT, LUKOVË LOTI 1	734,640.00
602	Mirëmbajtje e shëtitoreve Jal, Dhërmi, Himarë, Qeparo V2023	1,748,538.00
231	PËRMISIMI I NDRIÇIMIT NË FSHATIN KUÇ LOTI 2	4,910,138.40
602	Shpenzime per pastrimin NjA Lukove dhe Hore - Vranisht (Viti 2023)	8,284,677.00
231	SHPENZIME MBYKQYRJE PUNIMESH	3,174,000.00
231	SHPENZIME PER KOLAUDIM	2,000,000.00
231	RIKONSTRUKSION RRUGET STEFANEL SEGMENTI (4_6)	34,535,174.00
231	VENDOSJE E SISTEMIT TE KAMERAVE NE GODINAT PUBLIKE DHE KRYQEZIME KRYESORE	9,590,387.00
602	Shpenzime per materiale dezifektimi	478,464.00
602	Mirembajtje e Hapesirave te varrezave dhe siperfaqeve të gjelberta V 2024	20,023,824.00
231	RIKONSTRUKSIONI I RRUGES DHE SHESHIT TE VARREZAVE TE REJA, HIMARE	28,657,370.00
231	RIKONSTRUKSION RRUGET STEFANEL SEGMENTI (7_8)	42,487,059.00
231	NDERTIMI I PALESTRES SE MBYLLUR SHKOLLA BORSH	17,305,345.00
231	NDERTIMI I KOMPLEKSIT RAJONAL SPORTIV BORSH-QAZIM PAL(LOTI 2)	8,072,812.00
602	Shtrimm rrjeti fiber optike & interneti Himare	1,000,000.00
602	Shpenzime per mirmbajtje Mjetet e Bashkise (shpenzime per mirmebajt e mjeteve mzsh)	1,000,000.00

602	Shpenzime per Materiale Ndertimi & Hidraulike	1,497,480.00
602	Blerje paisje per MZSH-ne	1,000,000.00
231	Përmirësimi i ndriçimit Shkallë, Borsh	1,974,600.00
602	Energji Ekeltrike	1,069,350.00
602	Kolaudim i kanaleve vaditese	40,000.00
		208,746,568

(Tabela 2.0)

SHPENZIMET OPERATIVE INVESTIMET E BUXHETIT FAKTIK 2024

Shpenzimet operative (llog 602) janë tërësia e mallrave dhe shërbimeve të cilat paguhen në vitin korrent. Duke filluar me hyrjen në fuqi të VKM Nr. 9 Dt 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste” e cila ka si qëllim kontrollin e projektit në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike, standardet shqiptare në fuqi ose standardet evropiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, si dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

Oponenca teknike kryhet për studim-projektim në fushat:

- a) sociale, kulturore, shëndetësore, arsimore, shkencore, sportive dhe varreza;
- b) infrastrukurore;
- c) hidrike;
- ç) e transmetimit të energjisë;
- d) e rrjeteve inxhinierike;
- dh) e grumbullimit e të trajtimit të mbetjeve;
- e) e banimit dhe shërbimit;
- ë) industriale;
- f) bujqësore;
- g) financiare;
- gj) administrative;
- h) akomoduese dhe çlodhjeje.

Duke marrë parasysh vlerën dhe koston e oponencave teknike, e cila parashikohen në Aneksin 1 të VKM Nr 9 dt 11.01.2024, ku vlera e oponencave shkon deri ne 7% për projektet nën 50 milionë lekë. Duke marrë parasysh se projektet e bashkisë janë mesatarisht 35 milionë

lëkë atëherë kemi llogaritur shtesën në vlerën për oponencat teknike deri në 23,000,000 lëkë për vitin 2024.

Nga sistemimet e llogarive ekonomike të pagave dhe sigurimeve, përlllogaritja e vlerës së re të detyrimeve të prapambetura dhe fondeve rezervë, por edhe shpenzimeve të tjera të detyrueshme rezulton diferenca pozitive prej **336,204,565** lekë. Kjo diferencë do të shpërndahet me investimet dhe shpenzimet operative si më poshtë;

SHPENZIME OPERATIVE DHE INVESTIME		Shtesa
602	Trajnime per keshilltaret bashkiak	500,000
602	Udhetime Dieta	1,000,000
602	Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve	10,000,000
602	Shpenzime per larjen e fasadeve te godinave	1,000,000
602	Shpenzime per aktivitete kulturore ne sezonin veror	4,000,000
602	Materiale per punime hidroizolimi	1,000,000
230	SHPENZIME PER OPONENCAT TEKNIKE	23,000,000
230	SHPENZIME PER KOLAUDIM	1,000,000
231	RIKONSTRUKSIONI I RRUGES BORSH - FTERRE LOTI 1	70,000,000
231	RIKONSTRUKSIONI I RRUGES BORSH ÇORRAJ LOTI 1	70,000,000
231	RIKONSTRUKSIONI I RRUGES HORË VRANISHT-VRANISHT LOTI 1	70,000,000
231	RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS LIDHËSE I FSHATIT TËRBAÇ ME RR.NACIONALE LOTI 1	84,704,565
TOTAL		336,204,565

(Tabela 3.0)

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, shpenzimet më të mëdha janë në projektet e rëndësishme të infrastrukturës, të cilat janë jetike për banorët e zonës dukë bërë lidhjen e fshatrave me rrugët nacionale tashmë të investuara plotësisht. Duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara financiare krahasimisht me vlerën e projekte të plota të këtyre akseve lidhëse, janë parashikuar vetëm lolet e para të këtyre veprave infrastrukturore.

DREJTOR DFPIE

Laert Mezani

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro

